



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.181

19 dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1203, datë 27.8.2008	Për përcaktimin e vlerës së saktë, në përqindje, të rentës së pasurisë minerare sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh	8985
Vendim i KM nr.1540, datë 19.11.2008	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, si autoritet kontraktor.....	8987
Vendim i KM nr.1542, datë 19.11.2008	Për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit për Kuvendin e Shqipërisë, si autoritet kontraktor	8987
Vendim i KM nr.1543, datë 19.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si autoritet kontraktor	8988
Vendim i KM nr.1544, datë 19.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	8988
Vendim i KM nr.1545, datë 19.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Mbrojtjes, si autoritet kontraktor	8989
Vendim i KM nr.1548, datë 26.11.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.41, datë 11.2.1992 të kryesisë së Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, të disa objekteve”	8990
Vendim i KM nr.1549, datë 19.11.2008	Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2008-2009	8990

Vendim i KM nr.1550, datë 26.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore	8995
Vendim i KM nr.1553, datë 26.11.2008	Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të protokollit të Kiotos	8996
Vendim i KM nr.1554, datë 12.11.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Vermosh/Shkodër	8999
Vendim i KM nr.1557, datë 26.11.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kukës-Shishtavec.....	9003
Vendim i KM nr.1559, datë 26.11.2008	Për lejimin e kalimit tranzit të tetë autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	9004
Vendim i KM nr.1568, datë 3.12.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.1458, datë 5.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Brendshme, institucionet në varësi dhe njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete kontraktore” .	9005
Vendim i KM nr.1570, datë 3.12.2008	Për dhënie fondi ndihme partisë “Lidhja Demokristiane e Shqipërisë (LDK)”	9006
Udhëzim i MPÇSSHB nr.2365, datë 26.11.2008	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar..	9006
Vendim i ERE nr.129, datë 2.12.2008	Për licencimin e shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar	9009
Vendim i ERE nr.130, datë 2.12.2008	Për licencimin e shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike	9010
Vendim i ERE nr.131, datë 2.12.2008	Për fillimin e procedurave për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Antea Cement” sh.a. për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë	9011
Kërkesë e METE nr.7594/5, datë 20.11.2008	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë truall” që preken nga “Ndërtimi i nënstacionit të Bajram Currit”.....	9011
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Imer Çelhaka, duke caktuar si kujdestar apo përfaqësues ligjor të tij vëllain e tij, kërkuesin Mustafa Çelhaka.....	9012
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasin Nazmi Abduramani	9012
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Nazire Sanxhaku	9012

VENDIM
Nr.1203, datë 27.8.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË SAKTË, NË PËRQINDJE, TË RENTËS SË PASURISË
MINERARE SIPAS VLERËS SË TREGUT, PËR ÇDO MINERAL APO GRUP
MINERALES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlera e saktë, në përqindje, e rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, 15-ditëshin e parë të muajit shkurt, të çdo viti.

2. Sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008, vlera e saktë, në përqindje, e rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh, për vitin 2008, është sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kur prodhuesi i mineralit e përdor atë për të prodhuar koncentrat apo prodhime metalurgjike ose nënprodukte të naftës, ai e paguan rentën e pasurisë minerare, në bazë të vlerës së mineralit të futur në koston e produkteve përfundimtare (koncentratit apo prodhimeve metalurgjike apo nënprodukte të naftës). Sasia dhe kostoja e mineralit/naftës, të përdorur, deklarohen nga përdoruesi dhe miratohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), sipas një udhëzimi, të miratuar nga ministri përkatës.

4. Në rastin e eksportit të koncentreve apo të prodhimeve metalurgjike a nënprodukteve të naftës, që kanë në bazë përdorimin e mineraleve dhe të naftës, eksportuesi duhet t’u paraqesë autoriteteve doganore dokumentin, që vërteton origjinën e mineralit, të përdorur, për prodhimin e tyre.

5. Në rastin e shitjes së pasurisë minerare, për konsum final në tregun e brendshëm, renta minerare paguhet pranë organeve tatimore. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta minerare paguhet në degët doganore.

6. Në rast se organet, tatimore dhe doganore, vërejnë se çmimet e deklaruar të shitjes së produkteve minerare janë më të ulëta se çmimet e tregut, këto organe duhet t’i referohen dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare, për përcaktimin e vlerës së shitjes së produkteve minerare, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 7 të këtij vendimi.

7. Si burim informacioni për krijimin e dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare shërbejnë burime të tilla si: çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, investigimi i tregut, brenda dhe jashtë vendit, kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, çmimet e produkteve minerare, të ngjashme, që eksportohen, çmimet e paraqitura në deklaratën e eksportit, për subjektet e tjera, që veprojnë në të njëjtën industri.

8. Përcaktimi sipas pikës 7 të këtij vendimi, bëhet nga një komision, i përbërë nga specialistë, me përvojë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të cilët caktohen nga ministrat përkatës.

9. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1: PËRQINDJA E RENTËS MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

Nr.	Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit minerar	Përqindja e rentës minerare
I.	Grupi i pare (I) MINERALET METALIKE	
1	Mineralet e argjendit	10%
2	Mineralet e arit	10%
3	Mineralet e bakrit	4%
4	Mineralet e kromit	4%
5	Mineralet e nikelit (nikel-silikat)	4%
6	Mineralet e hekurit (hekur-nikeli)	4%
7	Mineralet e plumbit	6%
8	Mineralet e zinkut	4%
9	Të gjitha mineralet e tjera metalike	4%
II.	Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE	
10	Të gjitha mineralet jometalike	4%
III.	Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET	
11	Qymyret	4%
12	Bitumet	4%
13	Rërat bituminoze	4%
14	Reshpet naftore	4%
15	Pirobitumet	4%
IV.	Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT	
16	Graniti	6%
17	Gëlqerorët	4%
18	Gabrot	5%
19	Bazaltet	4%
20	Konglomerate	5%
21	Mermeri	4%
22	Pllakat e ndërtimit	10%
23	Pllagjiogranitet	4%
24	Ranoret	4%
25	Serpentinitet	4%
26	Travertinat	4%
27	Traktolitet	5%
28	Të gjitha mineralet e tjera të grupit të katërt	4%
V.	Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR	
29	Të gjitha mineralet e grupit të pestë	10%
VI.	Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI	
30	Të gjitha mineralet e grupit të gjashtë	10%
31	Grupi i shtatë (VII) NAFTA DHE GAZI	10%

VENDIM
Nr.1540, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR

ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm t’i përfundojë procedurat e prokurimit, për mallra dhe shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, brenda datës 31 dhjetor 2008.

Brenda këtij afati përfshihen edhe nënshkrimi dhe realizimi i kontratës.

2. Ngarkohen Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1542, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit, për vitin 2008, për Kuvendin e Shqipërisë, si autoritet kontraktor, deri më 22 dhjetor 2008.

Brenda kësaj periudhe të përfshihen edhe publikimi i fituesit dhe publikimi i njoftimit të kontratës së lidhur në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen administrata e Kuvendit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1543, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit t’i përfundojë, deri në datën 25 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit elektronik, për tenderin, me objekt “Shtirirja me fibër optike për rrjetin kompjuterik ndërmëntor GovNet”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, zëri “Shpenzime për investime”.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Lejimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të publikojë njoftimin e kontratës së nënshkruar, për tenderin, me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1544, datë 19.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1.4 të kapitullit VII “Ceremonitë kryesore zyrtare”, të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet si një ditë e shënuar edhe data:

“20 nëntor

Dita e Alfabetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1545, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes t’i përfundojë, deri në datën 29 dhjetor 2008, procedurat

e prokurimit, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas tabelave nr.1, nr.2 e nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Nr.	Emërtimi i objektit	Fondi limit pa TVSH
1	Blerje karburanti gazoil - DI (Tender me negociim me shpallje)	195,694,958 lekë
2	Ndërtimi i kaponit Pashaliman	44,135,000 lekë
3	Ushqimi i gatuar në FA (Tender 2-vjeçar)	1,044,608,524 lekë
4	Blerje gazoi F-76 (Tender me negociim pa shpallje)	29.677.808 lekë
5	Blerje vajguri Jet A1 (Tender me negociim pa shpallje)	11.772.900 lekë

Tabela nr.2

Nr.	Emërtimi i objektit	Fondi limit pa TVSH
1	Blerje benzinë për FA	21.853.333 lekë
2	Studime, projekte, hartim të projektit të zbatimit për rikonstrukcionin e plotë të SHKU Pogradec	4.766.371 lekë
3	Rikonstrukcion ISPMB	11.200.000 lekë
4	Blerje uniformash të ndryshme: - Kostume civile - Bluza lirimale detari	8.490.000 lekë 636.000 lekë

Tabela nr.3

Nr.	Emërtimi i objektit	Fondi limit pa TVSH
1	Pajisje për demontim municionesh	145.000.000 lekë

Në tabelën nr.1- Janë vendosur procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë publikuar ende për t'u zhvilluar procedurat e prokurimit.

Në tabelën nr.2 – Janë vendosur procedura të zhvilluara, por që lidhja e kontratës nuk u realizua brenda datës 31.10.2008.

Në tabelën nr.3 - Janë vendosur prokurimet që mund të realizohen në qoftë se do të ketë oferta nga subjekte të ndryshme dhe realizohet procedura me negociim pa shpallje.

VENDIM

Nr.1548, datë 26.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.41, DATË 11.2.1992 TË KRYESISË SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË DISA OBJEKTEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.41, datë 11.2.1992 të kryesisë së Këshillit të Ministrave, nga lista e objekteve për Federatën e Rinisë Shqiptare të hiqet “Këndi i lojërave”, Burrel.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Burrel për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1549, datë 19.11.2008

**PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË
PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, të jenë 4 845. Këto kuota ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------|
| a) për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 3 045; |
| b) për programe të dyta studimi | 1 400; |
| c) për transferim studimesh | 200; |
| ç) për shtetasit e huaj | 200. |

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, sipas shkronjave “a” e “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Këto kuota ndahen në raportin 2:1, përkatësisht, pranime të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “a” të pikës 1, dhe programe të dyta studimi, sipas shkronjës “b” të pikës 1.

3. Kuota e pranimeve për transferim studimesh, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota e pranimeve për shtetasit e huaj, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahet, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe të kërkesave individuale të tyre.

5. Çdo shtetas shqiptar, që ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron dëftesë pjekurie a çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, ka të drejtë të kandidojë për t’u pranuar në studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

6. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve, në Tiranë, duhet t’u nënshtrohen kritereve të veçanta (konkurseve të pranimit), të vendosura nga ky institucion, për pranimet në këto programe studimi.

7. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar sipas pikave 1, shkronja “c”, dhe 3, të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të bëra publike, paraprakisht.

8. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet, me kohë të pjesshme, në një program të dytë

studimi, do ta fitojnë këtë të drejtë, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë dhe të bëra publike, paraprakisht.

9. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2008-2009, të jenë, si më poshtë vijon:

a) në Universitetin e Tiranës:	
i) Histori	52 000 lekë;
ii) Gjeografi	52 000 lekë;
iii) Gjuhë-Letërsi	52 000 lekë;
iv) Drejtësi	93 600 lekë;
v) Biologji	62 400 lekë;
vi) Financë-Kontabilitet	72 800 lekë;
vii) Administrim-Biznes	72 800 lekë;
viii) Psikologji	52 000 lekë;
ix) Punë sociale	52 000 lekë.
b) Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”:	62 400 lekë.
c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:	
i) Menaxhim agrobiznesi	52 000 lekë;
ii) Ekonomi dhe politikë agrare	52 000 lekë;
iii) Hortikulturë	52 000 lekë;
iv) Prodhim bimor	52 000 lekë;
v) Zootekni dhe biznes blegtoral	52 000 lekë;
vi) Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	52 000 lekë;
vii) Teknologji agroushqimore	52 000 lekë;
viii) Agromekanizim	52 000 lekë;
ix) Vreshtari dhe enologji	52 000 lekë;
x) Inxhinieri pyjesh	62 400 lekë;
xi) Inxhinieri përpunim druri	62 400 lekë;
xii) Financë-Kontabilitet	62 400 lekë;
xiii) Mbrojtje bimësh	62 400 lekë;
xiv) Agromjedis dhe ekologji	62 400 lekë.
ç) Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:	
i) Histori-Gjeografi	41 600 lekë;
ii) Gjuhë-Letërsi	41 600 lekë;
iii) Edukatë qytetare	41 600 lekë;
iv) Punë sociale	41 600 lekë;
v) Filozofi-Sociologji	41 600 lekë;
vi) Administrim-Biznes	52 000 lekë;
vii) Financë-Kontabilitet	52 000 lekë;
viii) Biologji-Kimi	52 000 lekë;
ix) Cikli i ulët	31 200 lekë;
x) Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
xi) Matematikë-Fizikë	31 200 lekë.
d) Në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë:	
i) Histori-Gjeografi	31 200 lekë;
ii) Financë-Kontabilitet	41 600 lekë;
iii) Biologji-Kimi	41 600 lekë;
iv) Cikli i ulët	31 200 lekë;
v) Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
vi) Matematikë- Fizikë	31 200 lekë;
vii) Gjuhë-Letërsi	31 200 lekë;
viii) Administrim publik	41 600 lekë;
ix) Menaxhim turizëm	41 600 lekë.
dh) Në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë:	

i) Gjuhë-Letërsi	31 200 lekë;
ii) Financë	41 600 lekë;
iii) Cikli i ulët	31 200 lekë;
iv) Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
v) Menaxhim biznesi	41 600 lekë;
vi) Turizëm	41 600 lekë;
vii) Hortikulturë	31 200 lekë;
viii) Agrobiznes	31 200 lekë;
ix) Marketing	41 600 lekë.
e) Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër:	
i) Gjeografi	41 600 lekë;
ii) Financë-Kontabilitet	52 000 lekë;
iii) Turizëm	52 000 lekë;
iv) Administrim- Biznes	52 000 lekë;
v) Biologji-Kimi	52 000 lekë;
vi) Histori	41 600 lekë;
vii) Cikli i ulët	31 200 lekë;
viii. Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
ix) Matematikë	31 200 lekë;
x) Fizikë	31 200 lekë;
xi) Gjuhë-Letërsi	41 600 lekë;
xii) Juridik	72 800 lekë.
ë) Në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë:	
i) Infermieri	41 600 lekë.

10. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbërit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat e papunë, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, nënat, që janë kryefamiljare, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, ish-të përndjekur politikë, që do të fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, përjashtohen nga tarifa e shkollimit.

Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që i përkasin po këtyre shtresave shoqërore.

11. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

12. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës.

13. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur në marrëveshjet zyrtare shtetërore janë përcaktuar mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave.

14. Kuotat e pranimeve në studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AEFS	Σ
1	Histori	150						60			210
2	Gjeografi	150						60			210

99	Inxhinien ndërtimi										0
100	Inxhinien hidroteknik										0
101	Arkitekturë										0
102	Inxh.Matematike										0
103	Inxh.Fizike										0
104	Inxhinier gjeodet										0
105	Inxh. Mjedis										0
106	Inxh. në shkencat e tokës										0
107	Inxh. Gjeoinformatike										0
108	Inxh. i Gjeoburimeve										0
109	Menaxhim agrobiznesi			50			20				70
110	Ekonomi dhe P.Agrare			50							50
111	Finance-Kontabilitet			50							50
112	Mbrojtje bimësh			50							50
113	Hortikulturë			50			30				80
114	Prodhim bimor			50							50
115	Zooteknia dhe biznesi Blegtoral			50							50
116	Akuakulturë dhe Menaxh.Peshkimi			50							50
117	Agromjedis dhe Ekologji			50							50
118	Tek. Agroushqimore			50							50
119	Vreshtari e hortologji			50							50
120	Inxhinier pyjesh			40							40
121	Inxhinier përpunim druri			40							40
122	Agromekanizim			25							25
123	Mjekësi veterinare										0
124	Inxhinieri agronomike										0
125	Shkenca të administrimit										0
126	Menaxhim turizmi					30					30
	GJITHSEJ	1390	0	655	760	450	340	750	150	60	4445

VENDIM
Nr.1550, datë 26.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE INSTITUCIONET NË
VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të institucioneve në varësi të saj, bashkisë Durrës, t’i përfundojnë deri më 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit për ndërtime, mallra e shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe publikimi i fituesit dhe publikimi i njoftimit të kontratës së lidhur në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**ANEKSI I PROJEKTVENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT
TË KONTRATËS PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA MINISTRIA E
ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE INSTITUCIONET E VARËSISË SË SAJ**

Nr	Emërtimi i projektit	Vlera limit në lekë	Financimi i vitit 2008 në lekë
I	APARATI I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS		
1	Blerje e mjeteve didaktike Arsimit bazë dhe i mesëm	306,433,267	306,433,267
2	Rikonstrukcioi i rrjetit elektrik të Godinës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës	10,795,260	7.950,000
II	UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës		
3	Pajisje Mobileri për Fakultetin e studimeve të Integruara me Praktikën Universiteti Durrës	3.333.600	3.333.600
4	Pajisje Elektronike për Fakultetin e studimeve të Integruara me Praktikën Universiteti Durrës	8.181.000	8.181.000
	AKADEMIA E SPORTEVE “VOJO KUSHI” TIRANË		
5	Ndërtimi i sallës së leksioneve dhe konferencave Akademia Sporteve Tiranë	10,000,000	10,000,000
6	Mirëmbajtje ndërtese Akademia e Sporteve Tiranë	2.000.000	2.000.000
	DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE Durrës		
7	Rikonstrukcioni i shkollës së mesme “Beqir Çela” Durrës	18,000,000	5.500,000
	DREJTORIA ARSIMORE QYTETI TIRANË		

8	Rikonstruksioni i shkollës së mesme të Gjuhëve të Huaja Tiranë	65,000,000	5.000.000
III	BASHKIA DURRËS		
9	Ndërtimi i Konviktit pranë konviktit Beqir Çela Durrës	50.000.000	15.000.000
	Totali	473.743.127	363.397.867

VENDIM
Nr.1553, datë 26.11.2008

PËR KRIJIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR TË PËRCAKTUAR TË MEKANIZMIT TË ZHVILLIMIT TË PASTËR, NË KUADËR TË ZBATIMIT TË ANGAZHIMEVE TË PROTOKOLLIT TË KIOTOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të protokollit të Kiotos, të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike, miratuar me ligjin nr.9334, datë 16.12.2004, të nenit 13 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të pikave 44 e 45, të nenit 3 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar (AKP), të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në zbatim të angazhimeve të ndërmarra, në kuadër të nenit 12 të protokollit të Kiotos.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

a) “Konventa”, konventa kuadër e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, në të cilën vendi ynë është palë, që nga viti 1994.

b) “Protokolli i Kiotos”, protokolli i konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike, i cili ka vendosur objektiva të detyrueshëm për reduktimin e shkarkimit të gazeve, me efekt serrë, për vendet e zhvilluara. Vendi ynë edhe pse nuk ka detyrime për reduktimin e gazeve, me efekt serrë, mund të marrë pjesë në mekanizmin për zhvillim të pastër (MZHP) dhe të jetë përfitues projektesh nga vendet e zhvilluara.

c) “Mekanizëm i zhvillimit të pastër (MZHP)”, mekanizmi i përcaktuar nga neni 12 i protokollit të Kiotos, me qëllim që:

i) të ndihmohen palët, që nuk bëjnë pjesë në grupin e vendeve të zhvilluara (aneksi I i konventës), për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm;

ii) të kontribuojë në plotësimin përfundimtar të synimeve të konventës;

iii) të ndihmohen palët e përfshira në aneksin I, të përmbushin angazhimet e tyre për reduktimin e shkarkimeve të gazeve, me efekt serrë.

ç) “Metodologjia bazë”, aplikimi i një qëndrimi të caktuar për një veprimtari në kuadër të MZHP-së, i cili ka parasysh sektorin dhe rajonin, siç përshkruhet në paragrafin 48, të modaliteteve dhe procedurave të këtij mekanizmi. Bordi ekzekutiv i MZHP-së, sipas të njëjtit paragraf, ka rënë dakord që, në rastin e një metodologjie:

i) të re (në hartimin e një metodologjie bazë të re), hapi i parë është identifikimi i përjasjes më të përshtatshme për veprimtarinë e projektit dhe, më pas, i një metodologjie të zbatueshme;

ii) të miratuar, kur zgjedhin një metodologji bazë të miratuar, pjesëmarrësit e projektit, automatikisht, e kanë përcaktuar përjasjen për veprimtarinë e projektit të njëjtë me atë të metodologjisë.

d) “Metodologjia e monitorimit”, metoda e përdorur nga pjesëmarrësit e projektit për mbledhjen dhe arkivimin e të gjitha të dhënave përkatëse, të nevojshme për zbatimin e planit të monitorimit.

dh) “Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP)”, autoriteti kombëtar për MZHP-në, që caktohet nga pala përkatëse e protokollit të Kiotos.

e) “Letër miratimi (LM)”, një letër e nënshkruar nga Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, i vendit

pritës, për një projekt MZHP, ku konfirmohet se projekti, ashtu siç është propozuar, do të sjellë reduktim të shkarkimeve të gazeve, me efekte serrë, të cilat janë shtesë e atyre, që ndodhin në mungesë të projektit, dhe se zbatimi i projektit e ndihmon vendin pritës për të arritur objektivat kombëtarë të zhvillimit të qëndrueshëm.

e) “Letër pranimi (LP)”, letra ku konfirmohet, në parim, se vendi pritës, nuk ka vërejtje ndaj një projektideje të propozuar dhe se do ta mbështesë më tej zhvillimin e saj si një projekt i plotë MZHP.

f) “Projektideja (PI)”, përshkrim i një projektideje të re MZHP, ku jepet një vlerësim i parë e i përafërt i reduktimeve në shkarkimin e CO₂. PI shërben për t’i kërkuar AKP-së një letër pranimi dhe për të justifikuar, në një fazë të mëvonshme vlefshësi të projektit MZHP, se ky i fundit është marrë seriozisht parasysh në një fazë të hershme.

g) “Dokumenti i plotë i projektit (DPP)”, dokumentacioni, që përgatitet dhe paraqitet nga pjesëmarrësit e projektit, përpara një entiteti të pavarur ligjor, të akredituar nga bordi ekzekutiv i MZHP-ve, për të bërë të vlefshëm një projekt të propozuar.

gj) “Pjesëmarrësit e projektit”, entitete ligjore (publike apo private), që propozojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë projekte, në kuadër të MZHP-së.

h) “Ministër dhe ministri”, përkatësisht, ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministria, që mbulon fushën e mjedisit.

3. AKP-ja vepron si organizëm i specializuar, në përbërje të ministrisë, për të shqyrtuar dhe miratuar projektidet dhe projektet e mekanizmit të zhvillimit të pastër, që paraqiten nga propozues të ndryshëm, në kuadër të protokollit të Kiotos, si të përshtatshëm për t’u zbatuar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar përbëhet nga dy njësi: nga komiteti dhe nga sekretariati teknik. Komiteti i AKP-së përbëhet nga shtatë anëtarë, ndërsa sekretariati teknik nga katër anëtarë. Anëtarët e komitetit dhe të sekretariatit teknik janë ekspertë të fushave të ndryshme të mjedisit, me statusin e nëpunësit civil. Emërimi i anëtarëve të komitetit dhe të sekretariatit teknik, si dhe rregulla më të hollësishme, për mënyrën e funksionimit të këtyre njësive, përcaktohen me urdhër të ministrit.

Anëtarët e komitetit dhe të sekretariatit teknik nuk marrin shpërblim për pjesëmarrje në këto veprimtari.

5. Shpenzimet për krijimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar mbulohen nga buxheti i ministrisë.

6. Komiteti i AKP-së kryen këto funksione:

a) Bashkërendon, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, veprimtaritë për zbatimin e angazhimeve, të vendit tonë, si palë në konventën dhe në protokollin e Kiotos;

b) Siguron që projektet, në kuadër të MZHP-së, të zhvillohen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe sipas kuadrit të duhur të bashkëpunimit ndërkombëtar;

c) Autorizon, kur e vlerëson të nevojshme, në varësi të përmbajtjes dhe natyrës së projekteve, pjesëmarrjen e ekspertëve të ministrive të linjës, në AKP;

ç) Nxjerr, kur është e përshtatshme, kërkesat për miratimin e propozimeve për projekte;

d) Vlerëson praktikën e hartuar nga sekretariati teknik i AKP-së.

7. Sekretariati teknik i AKP-së është në shërbim të komitetit dhe kryen këto detyra:

a) Përgjigjet për zhvillimin normal të marrëdhënieve, ndërmjet propozuesve të projekteve dhe AKP-së, duke respektuar kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këtë vendim;

b) Pranon kërkesat e propozuesve të projekteve dhe realizon shqyrtimin paraprak të tyre;

c) Siguron bashkërendimin ndërsektorial të punës në procesin e shqyrtimit të kërkesës e të dokumentacionit shoqërues të projektit;

ç) Siguron realizimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projekteve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe me aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij;

d) Integron, në procedurën e vlerësimit të projektit, vërejtjet e ekspertëve të ministrive të linjës;

dh) Siguron realizimin e kërkesave të zhvillimit të qëndrueshëm për çdo projekt;

e) I paraqet komitetit, për shqyrtim e miratim, projektin e shtjelluar, sipas hapave të sipërpërmendur;

ë) Harton letrat e miratimit të projektit.

8. Paraqitja e projektideve dhe e dokumentit të plotë të projektit nga propozuesit, shqyrtimi dhe miratimi i tyre nga sekretariati dhe nga komiteti bëhen sipas procedurave dhe afateve të mëposhtme:

a) Propozuesi i projektit paraqet në AKP kërkesën dhe projektidenë. Projektideja përmban të dhëna paraprake për projektin e propozuar dhe përfshin:

i) Një përshkrim të shkurtër të projektit (lloji, madhësia, vendndodhja);

ii) Vlerësimin e reduktimeve të mundshme të shkarkimeve të gazeve, me efekt serrë, të krahasuara me skenarin e zakonshëm të biznesit;

iii) Metodën bazë dhe monitoruese, që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit;

iv) Vlerësimin e kostove të investimit të projektit dhe kohëzgjatjen e tij.

b) Sekretariati teknik vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga propozuesi brenda 25 ditëve nga data e dorëzimit të tij. Sekretariati teknik, brenda këtij afati:

i) vlerëson nëse aplikimi është i plotë dhe nëse drejtoritë e sektorët përgjegjës të ministrisë kanë përfunduar shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga propozuesi;

ii) kur e çmon të nevojshme, ua dërgon dokumentacionin, për vlerësim, ministrive të linjës;

iii) i kërkon propozuesit të dhënat shtesë dhe i integron ato në dokumentacionin fillestar, përpara fillimit të vlerësimit të plotë, nëse ekspertët e ministrisë apo të ministrive të linjës vlerësojnë se është i nevojshëm dokumentacion shtesë;

iv) i kërkon propozuesit të kryejë komunikimin me publikun e interesuar për projektin;

v) përgatit praktikën përfundimtare, brenda 5 ditëve-punë, të cilën ia paraqet komitetit të AKP-së, pas marrjes së komenteve dhe të mendimeve të ekspertëve të ministrisë dhe të ministrive të linjës.

c) Komiteti i AKP-së, në bazë të praktikës përfundimtare, merr një vendim paraprak, brenda 5 ditëve-punë nga data e paraqitjes së saj. Ai, gjithashtu:

i) merr vendim për miratimin e projektidesë;

ii) harton një letër pranimi me shpjegimet përkatëse, për rezultatin përfundimtar të shqyrtimit, që nënshkruhet nga ministri;

iii) vë në dijeni, me anë të letrës së pranimi, propozuesin e projektit për rezultatet e shqyrtimit fillestar, brenda afatit 25-ditor të shqyrtimit të projektidesë.

9. Pasi merr letrën e pranimi, propozuesi i paraqet, me shkrim, komitetit të AKP-së, dokumentin e plotë të projektit (DPP), në dy gjuhë, anglisht dhe shqip, si dhe në versionin elektronik, ku përfshihen:

i) Kërkesa e propozuesit, drejtuar komitetit të AKP-së;

ii) Një përshkrim i përgjithshëm i veprimtarisë së projektit;

iii) Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit;

iv) Një deklaratë e nënshkruar, për statusin, financiar dhe ligjor, të shoqërisë, e cila bën ofertën;

v) Dokumenti, që vërteton zbatimin e një metodologjie bazë dhe monitoruese;

vi) Kohëzgjatja e projektit/periudha kredituese;

vii) Çdo dokument apo e dhënë, e kërkuar nga sekretariati teknik në letrën e pranimi, si përgjigje ndaj projektidesë;

viii) Letër miratimi nga institucionet përkatëse për zhvillimin e veprimtarisë.

10. Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të dokumentacionit të plotë të projektit zgjat 30 ditë nga data e paraqitjes së tij. Brenda këtij afati, sekretariati teknik kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Kontrollon dokumentet për të parë, nëse aplikimi është i plotë, dhe ua nis ato, për mendim, ekspertëve mjedisorë të ministrisë dhe të ministrive të linjës, kur e çmon të nevojshme, të cilët, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit, vlerësojnë nëse ato:

i) janë në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, që zbaton vendi ynë;

ii) plotësojnë kërkesat e procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me ligjin nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;

iii) vërtetojnë pjesëmarrjen e secilit institucion në zbatimin e projektit;

iv) vërtetojnë qëndrueshmërinë ligjore dhe financiare, të pjesëmarrësve të projektit.

b) Pasi sekretariati teknik i AKP-së mbledh komentet e ekspertëve të ministrisë dhe të ministrive të linjës, harton praktikën përfundimtare, brenda 4 ditëve, të cilën ia paraqet komitetit të AKP-së, për marrjen e vendimit përfundimtar për projektin.

11. Komiteti i AKP-së, brenda 5 ditëve-punë, realizon shqyrtimin fillestar dhe merr, brenda 10 ditëve, vendimin përfundimtar. Vendimi dhe letra miratuese ose refuzuese nënshkruhen nga ministri, brenda 5 ditëve, pas datës së marrjes së vendimit përfundimtar të komitetit. Në letërën e refuzimit shpjegohen arsyet e mosmiratimit të projektit, si dhe jepen sugjerime për përmirësimin e tij, për një riparaqitje të mundshme.

12. Për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve MZHP, propozuesi i projektit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, paguan një tarifë shërbimi, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, në çastin e paraqitjes së kërkesës për miratim, e cila është e pakthyeshme edhe në rastet kur projekti nuk miratohet.

13. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1554, datë 12.11.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I PIKËS SË KALIMIT
KUFITAR VERMOSH/SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, sipërfaqe truall, në pronësi të z.Gjokë Mark Bunjaj, që preket nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Vermosh/Shkodër, sipas planrilevimit dhe planimetrisë së sheshit të ndërtimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, z.Gjokë Mark Bunjaj, të kompensohet, në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1153 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) m², tokë, të vlerësuar me çmimin e truallit 623 lekë/m², për zonën e Shkodrës, në masën 718 319 (shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 518 000 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 718 319 (shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, të përballohet nga “Llogaria speciale”, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.11.2008 dhe të përfundojë më 30.12.2008.

7. Afati i punimeve të ndërtimit të fillojë brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të përfundojë brenda 12 muajve.

8. Pronari i pasurisë së paluajtshme, i përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN RILEVIMI

PERGATITI:

Emri: NAIM LOSHA

Licensa Nr: T2 0064/ Date: 11/06/2003

Data e Pergatitjes: 24/07/2008

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE _____

NR. I PASURISE _____ VOL. _____ FQ. _____


INDEKSI I HARTES _____

SHKALLA 1:11,500

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER
 D/F MEHDIH GJOKAJ B/L GERAR

P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

PRONARI GJOK MARK BUNJAJ



110%

VLEREQA E PRONARIT GJOK MARK BUNJAJ ESHTE 1153 M²

VLEREQA RRETHA AUTO QE NDAN PASURINE NE

DY PJESE ESHTE 35.80 X 9.52 = 177 M²

SHUMA TOTALE = 1330 M²

SIPAS PLANIMETRIKE VE VLERESIT TE KORTMIT


KUFIZIMET E PROMES QE SHARHESOHET

TATE VETEM NIE PRONARIN GJOK MARK BUNJAJ


PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT: PIKA E KONTROLLIT KUFITAR - VERMOSH

SIPERFAQJA E SHESHIT 1 330 m² SH 1:500


SHK. 11250



SKEMA E VENDOSJES TE SHESHIT
NE RAJON SH 1:2000



POZICIONI KADASTRAL



PROJEKTI - STUDIO
LIVANCA - KOSOVULEP
ALBANIA



E. C. Delegation in Albania

E
F

VENDIM
Nr.1557, datë 26.11.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KUKËS-SHISHTAVEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kukës-Shishtavec, si rezultat i rrëshqitjeve.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 7 452 (shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) m², tokë/arë, me vlerë 2 012 040 (dy milionë e dymbëdhjetë mijë e dyzet) lekë, për kultura bujqësore, thekër, me vlerë 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi, 2 044 040 (dy milionë e dyzet e katër mijë e dyzet) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 294 500 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 044 040 (dy milionë e dyzet e katër mijë e dyzet) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 30 nëntor 2008 dhe të përfundojë më 30 dhjetor 2008.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE PRONAT E TË CILËVE PREKEN SI REZULTAT I SHKARJEVE NË
SEGMENTIN KUKËS-SHISHTAVEC**

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip/m ²	Çmimi	Vlera	Thekër vlera/lekë	Shënime
1	Zize Idriz Mustafa	3432	8	arë	5492	270	1482840	32 000	I konfirmuar nga ZVRPP
2	Elmaz Avdil Serjani	3432	20	arë	520	270	140400		I konfirmuar nga ZVRPP
3	Bajram Elmaz Serjani	3432	21	arë	120	270	32400		I konfirmuar nga ZVRPP
4	Elmaz Avdyl Serjani	3432	23	arë	600	270	162000		I konfirmuar nga ZVRPP
5	Havzi Halim Serjani	3432	24	arë	720	270	194400		I konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma				7452	270	2012040	32 000	2 044 040

Vlera totale e shpronësimit është 2 044 040 (dy milionë e dyzet e katër mijë e dyzet lekë).

VENDIM
Nr.1559, datë 26.11.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË TETË AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 28 nëntor 2008.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete dhe 43 (dyzet e tre) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 29 nëntor 2008.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 20 (njëzet) automjete dhe 47 (dyzet e shtatë) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 1 dhjetor 2008.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 23 (njëzet e tre) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit- Qafë-Thanë, në datën 2 dhjetor 2008.

5. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 7 (shtatë) automjete dhe 14 (katërmëdhjetë) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë- Porti i Durrësit, në datën 4 dhjetor 2008.

6. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 7 (shtatë) automjete dhe 14 (katërmëdhjetë) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit- Qafë-Thanë, në datën 5 dhjetor 2008.

7. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 31 (tridhjetë e një) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë- Porti i Durrësit, në datën 7 dhjetor 2008.

8. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 10 dhjetor 2008.

9. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 28 nëntor, 1, 4 e 7 dhjetor 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

10. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në

datat 29 nëntor, 2, 5 e 10 dhjetor 2008, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

11. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

12. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

13. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1568, datë 3.12.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.1458, DATË 5.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E BRENDSHME, INSTITUCIONET NË VARËSI DHE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, SI AUTORITETE KONTRAKTORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të vendimit nr.1458, datë 5.11.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohen pikat 3/1 e 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Procedurat e prokurimit për objektet nr.4 e nr.6 të aneksit nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për njësinë e zhvillimit të prokurimeve të përqendruara, të përfundojnë deri më 31 dhjetor 2008.

3/2. Brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, autoritetet kontraktore, për të cilat prokuron njësia e zhvillimit të prokurimeve të përqendruara, të bëjnë lidhjen e kontratës dhe shpalljen e saj në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1570, datë 3.12.2008

PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË “LIDHJA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË (LDK)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për

partitë politike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Lidhja Demokristiane e Shqipërisë (LDK)” t’i jepet një fond, prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.2365, datë 26.11.2008

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.277, DATË 18.6.1997
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Personat që plotësojnë kërkesat e ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, duhet të paraqesin kërkesën e tyre për trajtim pranë seksionit të ndihmës ekonomike dhe të përkujdesit shoqëror, në njësinë administrative ku ata janë banorë të regjistruar sipas gjendjes civile.

2. Krahas kërkesës për trajtim, pretenduesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e tjera si më poshtë:

- a) Certifikatë personale me fotografi, e cila ripërtërihet çdo fillim viti.
- b) Vendimin mjekësor të lëshuar nga KMPV, kur personi është komisionuar pas 1 janarit 2001 apo vendimi mjekësor i lëshuar nga KMCAP para 1 janarit 2001, në të cilin të jetë përcaktuar:
 - i) Shkalla e paaftësisë (grupi i parë ose i dytë);
 - ii) Përqindja e shikimit;
 - iii) Nevoja për kujdestar.
- c) Kopjen e librezës së punës të noterizuar ose vërtetimin e arkivit, kur ai ka qenë në marrëdhënie pune me kooperativën bujqësore.
- d) Deklaratën noteriale mes të verbrit dhe kujdestarit, si dhe adresën e kujdestarit.
- e) Certifikatën familjare, kur kujdestari i të verbrit është pjesëtar i familjes.
- f) Certifikatën e kujdestarit me fotografi, kur kujdestari është i zgjedhur jashtë familjes.

3. Si kujdestar i personit të verbër mund të jetë prindi i tij, një pjesëtar tjetër i familjes ose person i zgjedhur nga i verbri, me kusht që kujdestari të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Kujdestari duhet të pajiset me raport mjekësor, i cili duhet të përsëritet çdo vit.

4. Nëse personi i verbër nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, kujdestari i të verbrit zgjidhet nga prindi ose kujdestari ligjor, në ngarkim të të cilit është i verbëri. Kur prindërit janë të divorcuar kujdestari përcaktohet nga prindi, të cilit, me vendim gjykatë, i është dhënë përgjegjësia prindërore ndaj tij.

5. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, sipas përcaktimit të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, (i ndryshuar) është 8700 lekë në muaj. Masa e përfitimit për kujdestarinë është e njëjtë, pra 8700 lekë në muaj.

6. Pagesa e përfitimit për shkak të verbërisë, si dhe ajo e përfitimit të kujdestarisë bëhet çdo muaj. Tërheqja e pagesës mund të bëhet nga:

- a) vetë i verbri; ose
- b) kujdestari me dokument identiteti ose certifikatë me fotografi.

Kur i verbri dhe kujdestari i tij nuk paraqiten në muajin përkatës për të tërhequr pagesën, atëherë pagesa mund të tërhiqet nga një pjesëtar tjetër i familjes i pajisur me prokurë të posaçme për këtë veprim.

7. Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi, vetëm për një shkollë, përfitojnë dyfishin e pagesës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, i ndryshuar, pra në masën 17 400 lekë në muaj.

8. Studentët e verbër të shkollave të larta, ose që përfshihen në studimet pasuniversitare, ose të verbrit që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 (i ndryshuar), në masën 26 100 lekë në muaj.

9. Për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, të verbrit nxënës, që vazhdojnë shkollat e mesme, të larta dhe studimet pasuniversitare, kanë të drejtë të marrin pagesën e verbërisë deri në përfundimin e ciklit shkollor. Pagesa që përfiton i verbri për gradën “Doktor i shkencave”, është e përhershme.

10. Të verbrit që vazhdojnë shkollën e mesme, të lartë, studimet pasuniversitare, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumente:

a) Vërtetim të firmosur nga titullari dhe sekretari i shkollës, i cili të përmbajë emrin e përfituesit, llojin e arsimit që ndjek, vitin shkollor, nëse është cikël normal me korrespondencë apo i përsëritur.

b) Vërtetim të formosur nga titullari dhe sekretari i shkollës për frekuentimin e shkollës nga përfituesi për çdo 3 muaj, për të verbrit që vazhdojnë shkollën me korrespondencë të paraqitet vërtetim që ka shlyer detyrimet para çdo sezoni.

c) Kopjen e noterizuar të dëftesës së shkollës të çdo viti për shkollën e mesme dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së lartë.

11. Të verbrit që ndjekin kurset e kualifikimit, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumente:

a) Vërtetim nga institucioni që organizon kursin, ku të jetë përcaktuar emri i kursantit, lloji i kursit dhe kohëzgjatja e tij;

b) Vërtetim për frekuentimin e kursit, kur ai zgjat mbi 6 muaj, vërtetimi paraqitet çdo 3 muaj;

c) Kopja e noterizuar e dëshmisë së kursit në mbarim të tij.

12. Të verbrit që kanë fituar gradën “Doktor i shkencave”, duhet të paraqesin si dokument shtesë origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton dhënien e gradës shkencore.

13. Të gjithë personat e verbër që kanë punuar në ndërmarrje shtetërore ose kooperative bujqësore para janarit 1991 dhe kanë humbur vendin e punës pas janarit 1991, përfitojnë 150% të vlerës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, (i ndryshuar), pra në masën 13 000 lekë në muaj, pasi ta kenë vërtetuar këtë fakt me:

i) paraqitjen e librezës së punës të fotokopjuar dhe të noterizuar; ose

ii) vërtetim nga arkiva, kur të verbrit kanë punuar në kooperative bujqësore.

Pagesa shtesë, mbi pagesën që përfitojnë të verbrit sipas pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, i ndryshuar, përfitohet deri në momentin që personi:

i) risistemohet në punë;

ii) mbush moshën për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë, pavarësisht nëse i përfiton nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

14. Personi i verbër përjashtohet nga skema e përfitimit për shkak të verbërisë, i merret librezja e verbërisë për një periudhë deri në 3 vjet, si dhe u nënshtrohet sanksioneve të përcaktuara në pikën 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, i ndryshuar, në rastet kur i verbri kryen veprime të qëllimshme për të përfituar pagesën për shkak të verbërisë si:

a) Falsifikim të dokumenteve të verbërisë, dëshmime apo dëftesave;

b) Refuzim të punësimit;

c) Refuzim i kualifikimit;

d) Mosparaqitja e dëshmime pas mbarimit të dy kurseve të kualifikimit.

15. Fondet e pagesave të pensioneve të invaliditetit të atyre personave që përfitojnë nga ligji

nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” mbulohen nga sigurimet shoqërore, ndërsa fondet e pagesave të verbërisë dhe të kujdestarisë të personave që përfitojnë nga ky ligj akordohen nga MPÇSSHB.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgon zyrtarisht tek administratori shoqëror dosjen e personit që është komisionuar së bashku me vendimin e KMPV dhe librezën e re të verbërisë, të lëshuar prej saj në modelin e miratuar nga ministri. Dosja shoqërohet me një fletinventari për dokumentet që ndodhen në të, një kopje e së cilës ruhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

17. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pajis me librezën e re të verbërisë të gjithë personat e verbër, afati i lëshimit të librezës të jetë deri në 3 vjet për personat që janë komisionuar deri në tre vjet dhe përgjithmonë. Për personat të cilët afatin e komisionimit e kanë deri në 1 vit, librezat e re të verbërisë do të përsëritet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror çdo vit.

18. I verbri, për pajisjen për herë të parë me librezën e verbërisë së re, paraqet tek administratori shoqëror, certifikatën personale me fotografi ose kartën e identitetit, si dhe tre fotografi të të njëjtit format me atë të certifikatës. Administratori shoqëror përcjell me shkresë zyrtare certifikatën dhe fotografinë e të verbrit në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, dhe kjo e fundit i përcjell ato zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pas plotësimit të librezave për çdo individ, harton listën me emrat sipas librezës, për zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

19. Zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror shpërndajnë në mënyrë zyrtare dhe dorëzojnë me procesverbal librezat e verbërisë tek administratorët shoqërorë të çdo njësie vendore.

20. Të verbrit për rinovimin e librezës së verbërimit të re, paraqesin pranë administratorit shoqëror librezën e verbërisë së cilës i ka mbaruar afati, certifikatën personale me fotografi dhe tri fotografi. Administratori shoqëror i përcjell këto dokumente sipas procedurës së përcaktuar në pikën 18 të këtij udhëzimi.

21. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, deri në nxjerrjen e librezës së re të verbërisë, pajis me vërtetim përfitimi nga statusi i të verbrit, të gjithë personat e përcaktuar në pikat 16 e 17 të këtij udhëzimi.

22. Udhëzimi nr.1766/1, datë 17.9.2003 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Anastas Duro

VENDIM **Nr.129, datë 2.12.2008**

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEN – I TIRANA” SHPK PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 9, dhe 45 pika 4, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa “d”, 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Gen-I Tirana” sh.p.k., ka nisur me

marrjen e vendimit nr.112, datë 16.9.2008.

2. Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike është paraqitur i plotë sipas rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007.

3. Shqyrtimi i këtij aplikimi bëhet sipas rregullores për procedurat e licencimit të miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007, mbasi në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, në nenin 20 përcaktohet se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gen-I Tirana” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike me një kohëzgjatje të vlefshmërisë së licencës prej 5 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.130, datë 2.12.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa “d”, 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Gen-I Tirana” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.111, datë 16.9.2008.

2. Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të

energjisë elektrike është paraqitur i plotë sipas rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007.

3. Shqyrtimi i këtij aplikimi bëhet sipas rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007, mbasi në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, e cila, në nenin 20, përcakton se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gen-I Tirana” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike me një kohëzgjatje të vlefshmërisë së licencës prej 5 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.131, datë 2.12.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË “ANTEA CEMENT” SHA PËR OBJEKTIN FABRIKA E ÇIMENTOS PRANË BURIZANËS, KRUIJË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 5, pika 2 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë.

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe vendimit nr.77, datë 14.12.2007 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Antea Cement” sh.a., për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË

Nr.7594/5, datë 20.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë truall” që preken nga “Ndërtimi i nënstacionit të Bajram Currit”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është: “OSSH” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT TË BAJRAM CURRIT”

RRETHI: TROPOJË

BASHKIA: BAJRAM CURRI

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë truall

SHPRONËSIMI DEFINITIV										
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e shpronësuar në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Adresa
1.	Aranit	Cel	Gjongecaj	Truall	1347	193/2	2952	4526	13360752	Bajram Curri
2.	Durim	Cel	Gjongecaj	Truall	1347	193/3	2952	4526	13360752	Bajram Curri
Shuma							2952	4526	13360752	

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr.869, datë 12.11.2008, ka vendosur shpalljen të zhdukur të shtetasit Imer Çelhaka, duke caktuar si kujdestar apo përfaqësues ligjor të tij vëllain e tij, kërkuesin Mustafa Çelhaka.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.1741, datë 31.10.2008, shpall të vdekur shtetasin Nazmi Abduramani, më datë vdekjeje 13.11.1991.

KËRKESË

Shtetasi Përparim Sanxhaku kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Nazire Sanxhaku.

KËRKUESI
Përparim Sanxhaku

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.12.2008
Doli nga shtypi më 19.12.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 32 lekë